



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë, më 23.01.2019

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES STATUSORE, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, “MBI KRYERJEN
E AKSIONEVE NGA AGJENCIA E ROJËS BREGDETARE DHE KUFIRIT
EVROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Hyrje

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 23.01.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, “Mbi kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni për Politikën e Jashtme caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elona Gjebrea.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm z. Julian Hodaj, Zëvendësministër i Brendshëm dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, “Mbi kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji vjen pas miratimit në parim të marrëveshjes, me vendimin Nr.269, datë 16.05.2018 të Këshillit të Ministrave.

Marrëveshja synon të koordinojë bashkëpunimin operacional ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë veprimet operationale në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe krijon një kuadër rregullator për bashkëpunimin ndërmjet agjencisë dhe ekipeve të saj, nga njëra anë, dhe autoriteteve kompetente të vendit tonë, nga ana tjetër.

Kjo marrëveshje ka ardhur si propozim i Bashkimit Evropian dhe synon të forcojë bashkëpunimin operativ mes vendeve të treta prioritare dhe Agjencisë së Rojës Bregdetare, si dhe të menaxhojë sa më mirë migracionin e parregullt e të risë sigurinë në kufijtë e jashtëm të BE-së.

Nëpërmjet ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, Agjencia e Rojës Bregdetare do të ketë kompetenca ekzekutive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kjo agjensi do të koordinojë bashkëpunimin operacional sa i takon menaxhimit të kufijve të jashtëm ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të treta. Gjithashtu, nëpërmjet një plani operacional dhe në përputhje me Direktivat e Kthimit, Agjencia mund të organizojë ose koordinojë edhe operationet e kthimit në rastet e flukseve të migracionit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje **nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit**, duke qenë se është në përputhje me programin e Ministrisë së Brendshme, dhe për rrjedhojë është e përfshirë në buxhetin e miratuar nga kjo ministri.

ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nga relatorja znj. Gjebrea u vlerësua rëndësia e marrëveshjes në kuadër të bashkëpunimit evropian dhe në luftën kundër migracionit të paligjshëm. Gjatë prezantimit të tij Z. Hodaj theksoi risinë që sjell kjo marrëveshje në kuadrin ligjor të Republikës së Shqipëri, në funksion të policisë shtetit. Deputetët ngjritën pyetje lidhur me gjendjen aktuale të migracionit të paligjshëm dhe efektet e marrëveshjes në aspektin operacional. Komisioni vlerësoi frymën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ndihmës mes agjencisë evropiane dhe autoriteteve kompetente të vendit tonë.

PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Politikën e Jashtme pasi vlerësoi se:

- a) Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

ELONA GJEBREA

KRYETARE

MIMI KODHELI